

VENDIM
Nr. 648, datë 5.10.2022

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ARSIMIT
DHE SPORTIT, PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS, TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, NË ZONËN KADASTRALE 8210, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 117, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, të pasurive të paluajtshme, në zonën kadastrale 8210, Bashkia Tiranë, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuritë e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi administrimi, përdoren në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Universitetit të Sporteve të Tiranës.


3. Universitetit të Sporteve të Tiranës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur këtij vendimi, t’i tjetërsojë apo t’ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

| Institucioni i Pashkëtit Qendror: Ministria e Arsimit dhe Sportit Universiteti i Sporteve të Tiranës | | | | Identifikoi: Ing.Sokol Allaraj | | | | | | |
|---|----------------------------------|--------------|-----------------|---|----------------------------|--------------------------------------|---|---|--|--|
| Fusha e përdorimit të Pronës: Arsim Publik | | | | Supervizoi: Mirlinda Galushi Administrator | | |  | | | |
| | | | | Aprovoi: Prof.Dragron Kasa Rektor | | | | | | |
| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones m2 | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8210(TR-N-8) | 3/61 | Rrugë | Rrugë e brendshme Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 288.9 | | Rrugë | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 2 | 8210(TR-N-8) | 3/62 | Trotuar | Trotuar i brendshëm Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 111.74 | | Trotuar | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 3 | 8210(TR-N-8) | 3/56 | Truall | Truall (Laboratori i Fizioterapisë) Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 1106.6 | | Truall | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | Mbi këtë truall ka ndërtesë pa leje Laborator i fizioterapisë është deklaruar sipas shkrësës nr. 404/1 datë 29.07.2014 |
| 4 | 8210(TR-N-8) | 3/178 | Truall | Fushat e Tenisit Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 1424.94 | | Fushat e tenisit dhe truall | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 5 | 8210(TR-N-8) | 3/186 | Truall/Ndërtesa | Truall /Ndërtesa Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 5068.56 | 2638.57 | Administratë dhe aktivitet arsimor dhe sportiv | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 6 | 8210(TR-N-8) | 3/176 | Terren sportiv | Fushë mini futbollit Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 631.68 | | Terren sportiv | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 7 | 8210(TR-N-8) | 3/177 | Terren sportiv | Terren sportiv Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 676.45 | | Terren sportiv ndihunës | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 8 | 8210(TR-N-8) | 3/185 | Terren sportiv | Terren sportiv Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 7239.44 | | Pista e atletikes dhe truall | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

| | | | | | | | | | | |
|----|---------------|-------|----------------|---|----------|--|---------------------|-----|------------------------------------|---|
| 9 | 8210(TR-N-8) | 3/203 | Terren sportiv | Fusha e futbollit Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 10148.69 | | Fusha e futbollit | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | |
| 10 | 8210(TR-N-8) | 3/175 | Godine | Godine ,Salla e lojrave Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 1611.85 | | Truall nën ndërtesë | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | Palestra e Lojrave e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit KRRTI Vendi nr. 24 date 11.02.2005 |
| 11 | 8210(CTR-N-8) | 3/220 | TRUALL | Rr.Muhamet Gjollësia ,Tiranë | 285.3 | | Truall | MAS | Universiteti i Sporteve të Tiranës | Shtet |